

Angazhime dhe investime që do të kryhen sipas Programit të Qeverisë 2021-2025

Në sektorin ekonomisë, biznesit dhe investimeve:

- Modernizimi i ekonomisë prodhuese, turizmit, ekonomisë digjitale, bujqësisë, konektivitetit dhe energjisë;
- Vijim i rritjes ekonomike të qëndrueshme;
- Ndërmarrjet e manufakturës do të kalojnë në nivelin tjetër, në ciklin e plotë të prodhimit duke promovuar markën “Made in Albania”, me të cilën do të konkurrojmë globalisht;
- Shqipëria do të jetë një qendër rajonale për sipërmarrjet e reja në ekonominë digjitale, duke siguruar dhe punësimin e të rinjve;
- Nga 1 janar 2021, rimbursimi i TVSH-së për bizneset do të jetë automatik;
- Fondi i mbështetjes për sipërmarrjet e reja start-up do të arrijë në 10 mln Euro (do të 5-fishohet);
- Do të përdoret instrumenti i amortizimit të përshpejtuar gjatë vitit, për të nxitur investimet me pajisje të prodhuara brenda vendit

Në sektorin e infrastrukturës rrugore:

Investime në infrastrukturën rrugore me qëllim përmirësimin e lëvizjes së njerëzve dhe të mallrave, me standard sigurie dhe impakt në zhvillimin ekonomik dhe turizëm

- Do të përfundojnë brenda vitit 2021 punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit;
- Aksi Kardhiq-Delvinë do të përfundojë tërësisht në pranverën e vitit të ardhshëm (Maj 2022)
- Ndërtimi i korridorit blu (Kashar- Fier) duke kaluar përmes Milotit, Thumanës dhe Rrogozhinës.
- Ndërtimi i bypassit të Gjirokastrës (Muriqan- Kakavijë)
- Ndërtimi i bypass të Elbasanit
- Përfundimi i unazës së Tiranës

Në sektorin e transportit hekurudhor:

- Nisin brenda vitit 2021 punimet për Hekurudhën Tiranë-Rinas-Durrës
- Projekti për ndërtimin e hekurudhës Vorë- Hani i Hotit, me qëllim lidhjen e thjeshtë me Malin e Zi
- Banka europine e investimeve pritet të financojë hekurudhën Durrës- Rrogozhinë- Pogradec
- mbështetje hekurudhore në zonën afër Vlorës

Në sektorin e transportit ajror:

Vendosjen e më shumë se një aeroporti, me fokus në turizëm dhe lëvizjen me kosto të ulët të qytetarëve shqiptarë

- brenda vitit 2021 nisin punimet për VIA (Vlora International Airport) që ky aeroport të jetë operacional më 2024,;
- brenda vitit 2021 do të nënshkruhet kontrata për ndërtimin e SIA (Saranda International Airport), i cili do të behet i vogël, sezonal turistik;

- Do të vazhdojë rritja e kapaciteteve të avionit civil dhe zgjerimi aeroportit ‘Nënë Tereza’, ku do të zgjatet pista.

Në sektorin e transportit detar:

Risia e mandatit të tretë do të jenë portet dhe marinat e jahteve moderne, të vendosura përgjatë gjithë vijës turistike, në shërbim të zhvillimit, si pjesë e ofertës më të mirë turistike të Detit Mesdhe

Vendosjen e porteve moderne, porteve të mallrave, porteve të hidrokarbureve, porteve të pasagjerëve dhe marinave të specializuar në shërbimet e tyre

Ndërtimi i katër porteve turistike Sarandë, Vlorë, Durrës dhe Shëngjin

- Porti i Vlorës, i cili do të behet një port jahtesh
- Lëvizja e portit ekonomik (Triporti për transport mallrash)
- Nis në janar 2022 puna për transformimin e Portit aktual të Durrësit në një hapësirë moderne të kompletuar me një marinë jahtesh, infrastrukturë turistike dhe komplekse rezidenciale që do të pozicionojë Shqipërinë në hartën e turizmit elitare mesdhetar

Në sektorin e energjisë:

- Shqipëria do të jetë një vend eksportues neto i energjisë elektrike në të gjithë rajonin
- Sistem energjie shumë më të diversifikuar,
- Kompensimi i reduktimit të energjisë hidrike të rinovueshme përgjatë thatësirave me energji të gjelbër, të prodhuar nga impiantet diellore dhe ato të erës,
- Brenda marsit të vitit 2022, do të nënshkruhet kontrata për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, i cili do të shërbejë dhe për t'i dhënë fund përfundimisht përmbajtjeve në veri-perëndim të Shqipërisë.
- Brenda qershorit 2022 do të nënshkruhet kontrata për fillimin e punimeve për TEC Vlorën, projekt i cili përfshin konvertimin e TEC Vlorës me LNG (gaz të lëngshëm natyror), tek ndërtimi i një terminali rigazifikimi e deri tek shpërndarja në shkallë të vogël e LNG, duke shndërruar Vlorën në një HUB rajonal;
- Në mars 2022, do të nisnin punimet për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik të Karavastasë prej 140 MW, më i madhi në Ballkan Pas nisjes së punës për parkun me energji diellore të Karavastasë, do të ngrihet dhe parku me energji diellore në Spital. Këto do të rrisin kapacitetet prodhuese të vendit.
- Po ashtu, po përgatitet futja në përdorim e energjisë së erës.
- Në shkurt 2022, Bursa Shqiptare e Energjisë do të bëhet krejtësisht operacional.

Në sektorin e teknologjisë së informacionit

- Krijohet instrumenti i garancisë prej 50 mln Euro për manufakturën në rastet e ndryshimit të porosive, për përballimin e kostove të ndërrimit dhe kalimit në linja prodhimi të reja
- Do të krijohen programet “Inovacion dhe ekselencë në manufakturë” dhe “Inovacion dhe ekselencë në IT” për trajnime në inovacion, dizajn, marketing, kërkim dhe zhvillim nëpërmjet mbulimit të kostove të trajnimit 100%. Kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si dyfish i tatimit të zbritshëm ndaj shoqërive ku është i punësuar përfituesi
- Tatim-fitimi vetëm 5% për sipërmarrjet në IT
- Do të krijohet instrumenti i garancisë për kreditim në IT prej 50 mln Euro

- Modernizimi i shërbimeve dhe infrastrukturës digjitale për luftimin e korrupsionit dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve ndaj publikut dhe produktivitetin e sipërmarrjes
- Do të sigurohet marrja e përgjigjes online me nënshkrim ose vulë elektronike për të gjitha shërbimet në e-Albania
- Do të digjitalizohen arkivat fizike për të rritur numrin e shërbimeve në kohë reale me vulë elektronike
- Do të realizohet platforma e-Rezidenca për mundësimin e investimeve të huaja pa nevojën e prezencës fizike të investitorëve, duke përdorur identitetin digjital dhe shërbimet elektronike në e-Albania
- Do të zgjerohet rrjeti qeveritar GovNet për të ulur koston e shërbimit të internetit për institucionet shtetërore dhe rritjen e sigurisë së të dhënave
- Do të mundësohet njohja e nënshkrimit dhe vulës elektronike me vendet e rajonit

Në sektorin e bujqësisë

- Synohet që Shqipëria të shtojë prodhimin, të rrisë cilësinë dhe certifikimet standarde me qëllim kthimin në një aktor të rëndësishëm të eksporteve bujqësore
- Do të vijohet me politikat për diversifikimin e hapësirave e mundësive për aktivitetet ekonomike
- Do të nxitet rritja e ndërveprimeve ekonomike e sociale përmes vijimit të investimeve në ujësjellës-kanalizime, energji elektrike, shërbime shëndetësore e arsimore, infrastrukturë rrugore dhe në përmirësimin e teknologjisë së njohurive prodhuese.
- Do të vijohet me mbështetjen për rritjen e eksporteve nëpërmjet orientimit të investimeve në shtimin e zinxhirëve të vlerës në agro-përpunim, lehtësirave në blerjen e makinerive dhe pajisjeve të agro-përpunimit duke i ofruar sipërmarrjeve ekzistuese të përdorin një amortizim të përshpejtuar me dy herë, nëpërmjet rritjes së aksesit në tregjet e reja ndërkombëtare nëpërmjet informimit dhe lehtësimit të marrëveshjeve tregtare.
- Synohet zhvillimi i fshtatit drejt turizmit rural nëpërmjet mekanizmave mbështetëse për rritjen e numrit të bizneseve agro-turistike dhe bujtinave, nëpërmjet politikave nxitëse dedikuar emigrantëve, të rinjve dhe rritjes së përfshirjes së grave në sektor.
- Do të rritet mbështetja në bujqësi, blegtori dhe zhvillim rural me 70 mln Euro mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët nëpërmjet naftës pa akcizë dhe skemave kombëtare të mbështetjes
- 146 mln Euro mbështetje nëpërmjet programit IPARD III,
- TVSH zero për makinat bujqësore si në import ashtu edhe brenda vendit, për 27 zëra doganorë të peshkimit, për rrjetat, anijet, pajisjet elektronike, frigoriferët, motorët e anijeve etj., në bordin e anijeve të peshkimit të trajtuara si furnizime bordi
- Tarifa zero për regjistrimin dhe vaksinimin e detyruar të blegtorisë
- Blerja e gazoilut nga anijet e peshkimit me 0 akcizë, 0 taksë karburanti dhe 0 taksë karboni
- Tatim fitimi 5% për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor

Në sektorin e mjedisit

- 1 Qershori i vitit 2022 do të jetë dita që vendi do të “çlirohet” nga qeset plastike.
- Folus tek mbajtja pastër e mjedisit
- Evidentimi i problematikave si mbipopullimi në sezon dhe strategji për shpërndarjen e saj ne kohe dhe vende.
- Rregullim ligjor për vijën bregdetare, përcaktimin e kufijve bregdetare, përcaktimin si prone e patjetërsueshme etj. (gati projekt- ligji)

- Ristrukturim i brendshme i ministrisë si dhe koordinim me bashkitë e vendit dhe përcaktimin e përgjegjësi në problematika të lindura gjatë sezonit
- Krijimi i strukturave suplementare në sezone
- Plan për menaxhimin e mbetjeve
- Zhvillimin e ligjit për mbrojtjen e pyjeve, ligj i cili u bë në vitin 2021

Në sektorin e turizmit

- Synohet kthimi i Shqipërisë në zgjedhjen e parë si destinacion turistik për rajonin dhe një destinacion me rëndësi për Evropën
- Do të inkurajohen brandet e mirënjohura ndërkombëtare për të investuar apo operuar në Shqipëri (pritet të vije në RSH Interkontinental Hotel)
- Do të përfundojë procesi i lëvizjes së mjeteve lundruese përmes platformës online të hyrje-daljeve
- Promovimi i Flamurit shqiptar në tregun ndërkombëtar, si destinacion tax-free
- strukture të qarta ligjore për hotelet me 4 dhe 5 yje
- Suport agroturizmit me lehtësira fiskale, programe etj

Në sektorin e arsimit

- Objektivi për arsimin është ndërkombëtarizimi i universitetit, duke hapur filiale dhe programe studimi nga universitetet më të mira ndërkombëtare dhe ofrimi i disa programeve të studimit në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare.
- bashkëpunimi me universitetet ndërkombëtare iniciativat me drejtuesit e universiteti Boku në Vjenë, me Institutin në Kamëz.
- me universitete italiane, Pulia-Vlorë, universiteti i Janinës me Gjirokastrës.
- Hapjen e filialeve këtu në Shqipëri: universiteti teknik i Stambollit.
- Projekte të përbashkëta, shkëmbime pedagogësh, lidhjen e tregut të punës.

Në sektorin e kulturës

- Do të vendoset në funksionim Skema Kombëtare "Bonusi i Rijetëzimit", një financim për restaurimin dhe kthimin e objekteve brenda qendrave historike, në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin
- Do të ndërtohet Parku i Artit, një hapësirë social-kulturore në zonën e Ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", duke përfshirë dhe zonën rreth saj, ku do të synohet ndërtimi i Muzeut të Filmit
- Do të nisnin punimet për ndërtimin e Muzeut Hebraik Shqiptar, si pjesë integrale e projektit të rivitalizimit të Qendrës Historike të Vlorës
- Do të përfundojë projekti i Rijetëzimit të Amfiteatrit të Durrësit

Në sektorin e shëndetësisë

- Do të përshtatet dhe zbatohet mekanizimi "One Health" si një politikë e re, inovative, e cila do të integrohet brenda një kuadri të gjerë e koherent politikash, përfshirë ato ekonomike, financiare, teknologjike, sociale por edhe politikën e jashtme. Kjo strategji bazohet mbi

parimin e "Shëndetit në cdo politikë" dhe "zhvillimin e qëndrueshëm" dhe synon krijimin e strukturave dhe incentivave për të bashkërenduar masat dhe politikat në një sërë sektorë, kryesisht në atë të shëndetësisë, bujqësisë dhe mjedisit, në një strategji koherente ndër-sektoriale zhvillimi, të koordinuar me organizatat ndërkombëtare si ËHO, FAO, OIE, etj.

- Rritje të investimeve në infrastrukturën shëndetësore duke përmirësuar kapacitetet, ruajtur forcën e punës në shëndetësi dhe duke promovuar kujdesin social, njësoj të rëndësishëm me atë shëndetësor.
- Do të nxitet inovacioni dhe rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit në shëndetësi